



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 123, Datë 16.08.2017

MBI

**KËRKESËN E KOMPANISË “KESH” SHA PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES NDËRMJET “KESH” SH.A. DHE “OST” SH.A., LIDHUR ME
PËRMBUSHJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK QË RRJEDH NGA
VENDIMI I ERE-S NR. 194, DATË 30.12.2016 “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË OST SH.A, LIDHUR ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT, SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 23, pika 12të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016; gjithashtu dhe në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjise elektrike dhe te gazit natyror; nenit 18 të “Kontratës për Sigurimin e Shërbimeve Ndihmëse dhe të Balancimit të Sistemit Elektroenergjitike”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e kompanisë “KESH” sh.a për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet “KESH” sh.a dhe “OST” sh.a, lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s Nr. 194, datë 30.12.2016 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sha, lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”

Konstatoi se:

- Me shkresën Nr. 619/1Prot, datë 04.08.2017 kompania “KESH” sh.a, ka paraqitur pranë ERE-s një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të lindur mes saj dhe kompanisë “OST” sha, si rezultat i përmbushje së detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga zbatimi i vendimit të ERE-s Nr. 194, datë 30.12.2016 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “OST” sha, lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”.

- *“Kontrata për Sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse të balancimit të sistemit energjitike” e nënshkruar nga “KESH” sh.a dhe “OST” sh.a, është miratuar me vendimin e ERE-s Nr. 79, datë 07.06.2016, mbi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik për periudhën kohore 01.01.2016 – 30.06.2016” midis “OST” sh.a. dhe KESH sh.a, aktualisht është në fuqi referuar Vendimit Nr.194, datë 30.12.2016 të ERE.*

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të ankesës së paraqitur nga kompania KESH sha, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s Nr. 194, datë 30.12.2016, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konform, *“Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjise elektrike dhe të gazit natyror”*.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.